



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2927/ 5 prot.

Datë 21/11/2025

V E N D I M
Nr. 1740/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21/11/2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës, me numër ankimi elektronik A/2025/5964 datë 20.10.2025, dhe me nr. 2927/2024 prot, datë 20.10.2025, të operatorit ekonomik “ALIAJ-79” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference Nr. REF-64647-10-13-2025, me objekt “Shërbim Mirëmbajtje për Impiantet e Ngrohjes në Objektet Arsimore dhe Publike”, me fond limit: 24.201.150 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 13.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “ALIAJ-79” SHPK me NIPT: L47521901E dhe me adresë: Rruga “Ruci”,

*Ndërtesë private 1-katëshe përballë xhamisë,
Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike,
Tiranë
*Adresa: Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i
Medresesë, Tiranë.*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.10.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference Nr. REF-64647-10-13-2025, me objekt “Shërbim Mirëmbajtje për Impiantet e Ngrohjes në Objektet Arsimore dhe Publike”, me fond limit: 24.201.150 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 13.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë.

II.2. Në datën 20.10.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5964, datë 20.10.2025 dhe me numër protokoll nr. 2927/2025 prot., datë 20.10.2025 e operatorit ekonomik “ALIAJ-79” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kërkesën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me anë të shkresën nr. 4074/5 prot, datë 31.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2927/1 prot, datë 11.11.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe vendimarrja për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “ALIAJ-79” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së paraqitur për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave operatori ekonomik ankimues “ALIAJ-79” SHPK ka dorëzuar shkresën e datës 20.11.2025 “Këkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës” protokolluar me tonën me nr. 2927/2, datë 20.11.2025, ku citohet; “I nderuar Komision i Prokurimit Publik ,

Në lidhje me nr. elektronik A/2025/5964 dhe nr. protokoli 2927/2025, datë 20.10.2025, të operatorit ekonomik “ALIAJ-79” SHPK , për procedurën e prokurimit me nr. REF-64647-10-13-2025 , me objekt: “ Shërbim mirëmbajtje për impiantet e ngrohjes në objektet arsimore dhe publike”, me fond limit 24,201,150 lekë pa TVSH, që zhvillohet nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë .

Bazuar në kthimin e përgjigjes nr. 4074/4, datë 31.10.2025, të sjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë, ju informojmë se jemi plotësisht dakord me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) dhe heqim dorë nga kërkesa për shqyrtimin administrativ të ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Duke marrë parasysh se jemi në prag të stinës së dimrit dhe temperaturat po ulen , shërbimi i mirëmbajtjes së impianteve të ngrohjes në institucionet arsimore dhe publike është urgjent dhe i domosdoshëm për funksionimin normal të shkollave dhe ambienteve të tjera publike. Për këtë arsye, jemi tërhequr nga vlerësimi i Komisionit të Prokurimit Publik, prandaj ju lutemi të merrni vendimin përkatës sa më shpejt , në mënyrë që procedura e prokurimit të vijojë dhe të garantohen kushte të përshtatshme për nxënësit.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin..”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik “ALIAJ-79” SHPK, për ndërprerje të shqyrtimit të ankesës, me numër ankimi elektronik A/2025/5964, datë 20.10.2025, dhe me numër protokoli nr. 2927/2024 prot, datë 20.10.2025, në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference Nr. REF-64647-10-13-2025, me objekt “Shërbim Mirëmbajtje për Impiantet e Ngrohjes në Objektet Arsimore dhe Publike”, me fond limit: 24.201.150 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 13.11.2024 nga autoriteti

kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë, Tiranë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës. 2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Në nenin 105 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet:

“Operatori ekonomik ankimues ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar, në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Me paraqitjen e kërkesës për tërheqje, ndërpritet shqyrtimi i ankesës menjëherë. Për efekt të tarifës, ankesa konsiderohet si e mospranuar, dhe tarifa e ankesës nuk kthehet.”

III.1.3. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka të drejtë që në çdo kohë, përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimin e tij.

Referuar kërkesës së tij operatori ekonomik ankimues “ALIAJ-79” SHPK, i cili me shkresën e datës 20.11.2025 “Këkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës” protokolluar me tonën me nr. 2927/2, datë 20.11.2025 ka kërkuar si në vijim: “I nderuar Komision i Prokurimit Publik,

Në lidhje me nr. elektronik A/2025/5964 dhe nr. protokoli 2927/2025, datë 20.10.2025, të operatorit ekonomik “ALIAJ-79” SHPK, për procedurën e prokurimit me nr. REF-64647-10-13-2025, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për impiantet e ngrohjes në objektet arsimore dhe publike”, me fond limit 24,201,150 lekë pa TVSH, që zhvillohet nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

Bazuar në kthimin e përgjigjes nr. 4074/4, datë 31.10.2025, të sjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë, ju informojmë se jemi plotësisht dakord me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) dhe heqim dorë nga kërkesa për shqyrtimin administrativ të ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Duke marrë parasysh se jemi në prag të stinës së dimrit dhe temperaturat po ulen, shërbimi i mirëmbajtjes së impianteve të ngrohjes në institucionet arsimore dhe publike është urgjent dhe i

domosdoshëm për funksionimin normal të shkollave dhe ambienteve të tjera publike. Për këtë arsye, jemi tërhequr nga vlerësimi i Komisionit të Prokurimit Publik, prandaj ju lutemi të merrni vendimin përkatës sa më shpejt , në mënyrë që procedura e prokurimit të vijojë dhe të garantohen kushte të përshtatshme për nxënësit.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin..”.

Bazuar në nenin 117 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar shoqëria “ALIAJ-79” shpk tërhiqet nga ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5964, datë 20.10.2025, dhe me numër protokolli nr. 2927/2024 prot, datë 20.10.2025 për dokumentat e tenderit me vullnetin e saj të lirë. Në këto kushte, për sa kohë që operatori ekonomik ankimues ka paraqitur kërkesë për tërheqje nga ankesa, si dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë shqyrtimin e ankesën ankimi elektronik A/2025/5964, datë 20.10.2025, dhe me numër protokolli nr. 2927/2024 prot, datë 20.10.2025, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative objekt-ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të përfundojë procedimin administrativ në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “ALIAJ-79” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference Nr. REF-64647-10-13-2025, me objekt “Shërbim Mirëmbajtje për Impiantet e Ngrohjes në Objektet Arsimore dhe Publike”, me fond limit: 24.201.150 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 13.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë.
2. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga “ALIAJ-79” SHPK.

3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

